UDHËZUES

PËR USHTRIMIN E TË DREJTAVE SOCIALE NË PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

Financuar nga Bashkimi Evropian

BE-ja me TY

Instituti për të drejtat e njeriut

UDHËZUES PËR USHTRIMIN E TË DREJTAVE SOCIALE NË PROCEDURAT ADMINISTRATIVE

Botues:
Instituti për të Drejtat e Njeriut

Për botuesin:
Margarita Caca Nikollovska

Redaktor:
Maria Çekrexhi

Autori:
Sandra Buzlieva

Lektorim:
Tatjana Stojanovska

Dizajni grafik:
Bisera Atanasovska

Shkup, 2026

Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij nuk pasqyron në asnjë mënyrë pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

HYRJE 4

PROCEDURA PARA ORGANEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORe 5

USHTRIMI I TË DREJTAVE NË PROCEDURËN E SHKALLËS SË PARË 6

USHTRIMI I TË DREJTAVE NË PROCEDURAT E SHKALLËS SË DYTË 10

MBROJTJA GJYQËSORE (KONTEST ADMINISTRATIV) 13

USHTRIMI I DISA PREJ TË DREJTAVE TË LIGJIT PËR MBROJTJEN SOCIALE 19

USHTRIMI I DISA PREJ TË DREJTAVE SIPAS LIGJIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR 21

USHTRIMI I DISA PREJ TË DREJTAVE TË LIGJIT PËR SIGURIMIN SHËNDETËSOR 30

HYRJE

Ky udhëzues u drejtohet atyre shtetasve që duan të ushtrojnë të drejtat e tyre sociale.

Qëllimi i Udhëzuesit është t'ju ndihmojë:

- të kuptoni se si funksionon procedura;
- të shmangni gabimet; dhe
- të mbroni të drejtat tuaja.

Por mbi të gjitha, pse nevojitet ky Udhëzues?

Ju ushtroni disa nga të drejtat tuaja, siç janë e drejta për ndihmë sociale, e drejta për pension, ndihma minimale e garantuar, përfitimet e ndryshme, shtesa për fëmijë, ndihma dhe kujdesi nga një person tjetër, pensioni i pleqërisë dhe invaliditetit, rehabilitimi profesional dhe të drejta të tjera përmes institucioneve.

Ky udhëzues shpjegon:

- Ku të drejtoheni;
- Si të paraqisni një kërkesë;
- Cilat janë të drejtat tuaja në procedurë; dhe
- Çfarë duhet të bëni nëse nuk jeni të kënaqur me vendimin.

Qëllimi i Udhëzuesit është t'ju ndihmojë të ushtroni të drejtat tuaja më lehtë, më shpejt dhe më qartë .

PROCEDURA PARA ORGANEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Për të fituar këto të drejta, shpesh herë duhet:


- Të paraqisni një kërkesë.
- Të kaloni një procedurë administrative.
- Të merrni një vendim nga një institucion kompetent.

Kjo procedurë quhet procedurë administrative. E gjithë procedura administrative mund të ketë disa faza:

- Procedura para institucionit të cilit i paraqitet kërkesa është procedurë e shkallës së parë.
- Nëse nuk jeni të kënaqur me vendimin, mund të paraqisni një ankesë deri tek autoriteti më i lartë. Kjo procedurë është një procedurë e shkallës së dytë.
- Nëse jeni të pakënaqur edhe me këtë vendim, mund të ngrini padi në Gjykatën Administrative. Kjo procedurë quhet kontest administrativ.
- Shtetasi i pakënaqur me vendimin e Gjykatës Administrative mund të ankohet në Gjykatën e Lartë Administrative.

Procedura administrative, në të njëjtën kohë, përcakton parimet me të cilat zhvillohet procedura.

Graf. 1 – Fazat e procedurës administrative



USHTRIMI I TË DREJTAVE NË PROCEDURËN E SHKALLËS SË PARË

Si të fillohet një procedurë e shkallës së parë?

Nëse dëshironi të ushtroni një të drejtë, duhet të paraqisni një kërkesë.

Procedura administrative do të konsiderohet e filluar nga data kur pala paraqet kërkesën.

Kërkesa paraqitet në formularin e përgatitur nga institucioni/administrata/organi publik:

- personalisht;
- me postë; ose
- në mënyrë elektronike.

Këshillë:

Siguroni dëshmi se kërkesa është paraqitur, pra se administrata e ka marrë atë. Zakonisht është një vulë pranimi e datës kur është paraqitur kërkesa. Pa dëshmi, do të jetë e vështirë të provoni se keni paraqitur një kërkesë, sepse kjo është veçanërisht e rëndësishme për ushtrimin e të drejtave tuaja, nëse administrata hesht.

E rëndësishme:

1. Siguroni dhe dorëzoni të gjitha provat dhe informacionet e kërkuara prej jush që zakonisht janë të listuara në formular.
2. Formulari duhet të tregojë gjithashtu se çfarë të dhënash do të japë administrata, sipas detyrës zyrtare. Nuk ke nevojë të dorëzoni këtë informacion. Nëse këto prova dhe të dhëna mbahen nga një organ tjetër, administrata do t'i marrë ato ex officio, në mënyrë elektronike, dhe ju duhet së pari të jepni pëlqimin për përdorimin e të dhënave personale në procedurë.

Në raste të caktuara, një procedurë administrative mund të niset nga organi administrativ/administrata.

Kujdes!

Gjatë gjithë procedurës, që nga parashtrimi i kërkesës e deri në përfundimin e saj, ka afate të cilat fillojnë të rrjedhin nga dita e dorëzimit të kërkesës

Si llogariten afatet?

Afatet zakonisht caktohen në ditë.

Dita e parë e afatit është e nesërmja nga dita e marrjes së vendimit dhe dita e fundit është dita kur skadon afati.

Shënim:

Dita e marrjes së vendimit nuk llogaritet në afatin e caktuar. Për shembull, nëse e keni marrë dokumentin më 4 prill, afati fillon nga 5 prilli, pra 5 prilli është dita e parë e afatit.

Nëse dita e fundit e afatit bie në një ditë jo pune ose në një festë publike, afati skadon ditën tjetër të punës.

Nëse provat, ankesa ose ndonjë parashtresë tjetër dërgohen me postë, për të respektuar afatin e caktuar është e nevojshme që ato të dërgohen me postë të rekomanduar, sepse në këtë rast vlerësohet se dorëzimi institucionit i është bërë në ditën e dorëzimit në postë. nim

Shënim:

Duhet të keni dëshmi nga zyra postare (vula/data) e datës së dorëzimit të pakos së rekomanduar.

E rëndësishme:

Këto rregulla të afatit kohor zbatohen për të gjitha fazat e procedurës.

A mund të modifikohet, plotësohet ose anulohet kërkesa?

1. Kërkesën mund ta ndryshoni, plotësoni ose anuloni.
2. Kërkesa mund të zgjerohet gjithashtu ose mund të paraqitet një kërkesë tjetër, me kusht që të bazohet në të njëjtat fakte.

Këtë mund ta bëni në çdo kohë gjatë procesit administrativ, domethënë përpara se administrata të sjellë vendimin përfundimtar. Mund të ankoheni nëse kërkesa nuk lejohet/pranohet.

Nëse hiqni dorë nga kërkesa, autoriteti do ta ndërpres procedurën.

Kujdes!

Procedura do të ndërpritet gjithashtu kur ju nuk përgjigjeni dhe nuk veproni sipas kërkesave të organit që zhvillon procedurën, pasi kjo tregon se nuk jeni të interesuar të vazhdoni procedurën.

E rëndësishme:

Nëse psrsshtroni një kërkesë, duhet t'u përgjigjeni të gjitha kërkesave të administratës brenda një kohe të caktuar. Për shembull, administrata mund t'ju kërkojë t'i shtoni një dokument kërkesës suaj.

E rëndësishme:

Ju lutemi njoftoni organin që trajton procedurën për çdo ndryshim të vendbanimit ose adresës së vendbanimit në kohën e duhur, në mënyrë që të mund t'i merrni kërkesat në kohën e duhur!

Shënim:

Edhe nëse hiqni dorë nga kërkesa juaj, procedurat mund të vazhdojnë deri në fund nëse organi vendos se kjo është në interes publik ose nëse kërkohet nga pala tjetër e përfshirë në procedurë.

Shënim:

Organi mundet gjithashtu të ndërpresë procedurën e filluar sipas detyrës zyrtare. Megjithatë, nëse procedura ka mundësi të fillojë edhe me kërkesën tuaj, ajo do të vazhdojë nëse ju e kërkoni këtë.

Pjesëmarrje aktive në procedurë

1. **Në procedurën administrative, ju mund:**

Të merrni pjesë në mënyrë aktive.

2. Të jeni të informuar – të njiheni me gjendjen e vërtetuar faktike dhe të deklaroheni për të, gjegjësisht, të paraqitni me shkrim ose me gojë, në procesverbal, vërejtje lidhur me vërtetimin e fakteve.
3. Të bëni pyetje
4. Të paraqisni prova.

A ka shpenzime?

Kur dëshironi të realizoni të drejta të caktuara sociale pranë organeve publike, procedura e zhvillimit është pa pagesë.

Deri në cilin afat duhet të përfundojë procedura, pra deri në cilin afat duhet të marrë vendim organi?

1. Procedura duhet të përfundojë brenda 30 ditëve nga dita e fillimit të saj, pra nga dita e paraqitjes së kërkesës, me të gjitha provat.
2. Afati mund të zgjatet për një maksimum prej 30 ditësh, në varësi të kompleksitetit të rastit.
3. Për zgjatjen e afatit dhe për datën e re të skadimit të tij, organi është i detyruar t'ju njoftojë.

E rëndësishme:

Nëse organi nuk i përgjigjet kërkesës suaj dhe nuk ju jep asnjë zgjidhje brenda afatit të përcaktuar, kjo quhet 'heshtje e administratës'. Në këtë rast, Ju keni të drejtë të paraqitni ankesë pranë organit të shkallës së dytë ose padi në Gjykatën Administrative, pasi shteti nuk e ka kryer punën e tij brenda afatit.

Mund të lexoni se si të paraqisni një padi për heshtjen e administratës në f. 14.

Qe kur zbatohet akti administrativ?

1. Aktivendimi është i vlefshëm nga momenti që ju është dorëzuar, ose nga momenti i përcaktuar në vetë aktin.
2. Aktivendimi është i vlefshëm deri në shfuqizimin, anulimin ose ndryshimin e tij me një akt tjetër ose me vendim.
3. Vlefshmëria mund të përfundojë pas skadimit të një afati kohor të caktuar ose pas përmbushjes së qëllimit.

Marrja e aktvendimit përfundon procedurën e shkallës së parë.

USHTRIMI I TË DREJTAVE NË PROCEDURAT E SHKALLËS SË DYTË

Po nëse jeni të pakënaqur me aktvendimin?

1. Nëse nuk jeni të kënaqur me aktvendimin, mund të ankoheni, të paraqisni një kundërshtim ose të kërkoni përsëritjen e procedurës.
2. Nëse ankesa ose kundërshtimi nuk është i garantuar me ligj, ju mund të filloni menjëherë një kontest administrativ.
3. Gjithashtu mund të hiqni dorë nga ankimi, derisa autoriteti dytësor të marrë një vendim, pas të cilit, në një rast të tillë, procedura pezullohet.
4. Çdo parashtrim, edhe pse nuk është shkruar si "ankim", konsiderohet ankim nëse është e qartë se qëllimi është kundërshtimi i aktvendimit.

E rëndësishme:

Duhet ta shfrytëzoni të drejtën e ankesës ose të kundërshtimit brenda afatit të përcaktuar në vendim.

- **Ankesa mund të paraqitet brenda afatit prej 15 ditësh nga dita kur ju është dorëzuar aktvendimi, gjegjësisht njoftimi, përveç nëse është përcaktuar një afat më i gjatë.**
- **Ankesën duhet ta paraqitni pranë organit të shkallës së dytë.**
- **Afati i saktë brenda të cilit mund të paraqitni ankesën dhe organi pranë të cilit duhet ta paraqitni atë, janë të shënuara në aktin që do të pranoni.**

Shënim:

Kushtojini vëmendje seksionit "Këshilla ligjore" dhe afatit, të cilat zakonisht gjenden në fund të aktit.

Çfarë duhet të përmbajë një ankesë?

Ankesa ka përmbajtjen e vet dhe ju duhet të kujdeseni që ajo të përmbajë të gjitha elementet e nevojshme.

Ankesa duhet të përmbajë:

1. Aktvendimin që kontestohet ose për të cilin keni paraqitur kërkesë, por nuk keni marrë përgjigje nga institucioni;
2. Autoriteti që ka sjellë aktvendimin ose që duhet ta kishte sjellë atë; dhe
3. Arsyet pse nuk jeni të kënaqur me aktvendimin ose mos sjelljen e tij.

Shënim:

Mund të paraqisni fakte të reja dhe prova të reja, por duhet të shpjegoni pse nuk i keni paraqitur ato në shkallën e parë.

E rëndësishme:

Kujdes afatet. Nëse ankesa paraqitet pas kalimit të afatit, organi i shkallës së dytë do ta refuzojë atë dhe nuk do ta shqyrtojë fare.

Çfarë efekti ka ankesa?

Kur paraqitni ankesë, ekzekutimi i vendimit shtyhet.

Përjashtim bëjnë:

- kur përcaktohet me ligj se ankesa nuk vonon ekzekutimin;
- nëse është e nevojshme të merren masa urgjente në interes të publikut; ose
- nëse për shkak të vonesës në ekzekutim do të pësoni dëme që nuk mund të kompensohen.

Si vendoset lidhur me ankesën?

1. Ankesa paraqitet pranë organit/institucionit të shkallës së dytë, i cili është i detyruar që të nesërmen, në formë elektronike, t'ia përcjellë atë organit të shkallës së parë dhe të kërkojë që ai, brenda një afati prej shtatë ditësh, të shqyrtojë nëse ankesa është e lejuar, e afatshme dhe e parashtruar nga një person i autorizuar.
2. Nëse gabimisht e paraqitni ankesën pranë organit të shkallës së parë, ai, brenda shtatë ditëve, do të shqyrtojë nëse ankesa është e lejuar, e afatshme dhe e parashtruar nga një person i autorizuar. Pasi të vendosë, ai do t'ia përcjellë ankesën organit të shkallës së dytë.
3. Organi i shkallës së dytë, gjithashtu, do të verifikojë nëse ankesa është e lejuar, e afatshme dhe e parashtruar nga një person i autorizuar.
4. Nëse organi i shkallës së dytë konstaton se ankesa është e palejuar, e pafatshme ose e parashtruar nga një person i paautorizuar, ai do ta hedhë poshtë ankesën.
5. Nëse nuk e hedh poshtë, organi i shkallës së dytë do ta shqyrtojë ankesën dhe mund ta refuzojë ose ta aprovojë atë, si dhe ta shfuqizojë aktin e shkallës së parë plotësisht ose pjesërisht, ose ta ndryshojë atë.
6. Nëse organi i shkallës së dytë konstaton parregullsi në aktvendimin e nxjerrë nga organi i shkallës së parë, ai mundet: a) të vendosë që aktvendimi është i nul; b) ta shfuqizojë atë, dhe nëse është nxjerrë nga një organ jokompetent t'ia përcjellë organit kompetent; c) ose ta kthejë pranë organit/institucionit të shkallës së parë për përsëritje të procedurës.

E rëndësishme:

Organi/institucioni i shkallës së parë është i detyruar të ndjekë plotësisht udhëzimet e dhëna në aktin e organit të shkallës së dytë.

E rëndësishme:

Nëse ankesa juaj aprovohet dhe lënda kthehet për rishqyrtim pranë organit/institucionit të shkallës së parë, ai është i detyruar të nxjerrë vendim të ri brenda afatit prej 30 ditësh.

Ankesë në rast të "heshtjes së administratës"


1. Kur organi/institucioni i shkallës së dytë përcakton se organi i shkallës së parë nuk e ka miratuar vendimin brenda afatit ligjor, ai do të udhëzojë organin e shkallës së parë të miratojë një vendim brenda një afati maksimal prej 30 ditësh.
2. Kur organi/institucioni i shkallës së dytë konstaton se aktvendimi i shkallës së parë nuk është nxjerrë pa arsyetim, ai duhet të vendosë vetë për kërkesën tuaj brenda afatit prej 30 ditësh, ose do të urdhërojë organin e shkallës së parë që të nxjerrë aktvendim brenda afatit prej 15 ditësh.
3. Në rast të "heshtjes" së përsëritur të organit/institucionit të shkallës së parë, organi/institucioni i shkallës së dytë është i detyruar që aktvendimin ta nxjerrë vetë.

Brenda cilit afat duhet të vendosë organi/institucioni i shkallës së dytë sipas ankesës?

Lidhur me ankesën duhet të vendoset pa vonesë, e më së voni brenda afatit prej 60 ditësh nga dita e dorëzimit të ankesës dhe të gjitha dokumenteve nga organi/institucioni i shkallës së parë pranë organit të shkallës së dytë.

Nëse organi i shkallës së dytë nuk e zgjidh lëndën brenda afatit prej 60 ditësh, ju mund të ngrini padi administrative.

Graf. 2 - Procedura e shkallës së dytë



MBROJTJA GJYQËSORE (KONTEST ADMINISTRATIV)

Kundër akteve të administratës/organeve publike, keni të drejtën e mbrojtjes gjyqësore. Kjo procedurë gjyqësore quhet "kontest administrativ".

Si mund të kërkoni mbrojtje gjyqësore?

Mbrojtja gjyqësore, pra kontesti administrativ, iniciohet me padi.

Për ngritjen e procedurave ligjore, akti duhet të jetë i formës së prerë.

Akti administrativ i formës së prerë do të thotë që institucioni ka marrë vendimin e tij përfundimtar dhe ju nuk mund të ankoheni më për të. Tani që ajo derë është e mbyllur, ju mund t'i drejtoheni Gjykatës Administrative.

Shënim:

Për të ditur nëse akti është i formës së prerë, shikoni në fund të dokumentit ku thuhet "Këshillë ligjore". Nëse akti është i formës së prerë, do të thotë se keni të drejtë të paraqisni ankesë në Gjykatën Administrative.

Kujdes!

Në rubrikën "Këshilla ligjore" do të shkruhet edhe afati brenda të cilit mund të bëni ankesë në Gjykatën Administrative. Pas përfundimit të afatit, e humbni atë të drejtë.

Gykata duhet ta zhvillojë procedurën shpejt, pa ndërmarrë veprime dhe pa shkaktuar shpenzime të panevojshme.

E rëndësishme:

Gjykata Administrative duhet të vendosë, me vendim, brenda një afati të arsyeshëm, domethënë jo më vonë se nëntë muaj nga data e dorëzimit të procesverbaleve ose nga krijimi i kushteve për vendimin mbi padinë.

Kujdes!

Padia nuk pengon ekzekutimin e aktit ndaj të cilit është depozituar, përveç rasteve kur rregullohet ndryshe me ligj, ose me kërkesë të paditësit, kur ekzekutimi i aktit do t'i shkaktonte atij dëme që do të ishin të vështira për t'u riparuar. Pas çdo kërkese për shtyrje të ekzekutimit të aktit të kundërshtuar, Gjykata merr vendim jo më vonë se shtatë ditë nga marrja e kërkesës.

Padinë mund ta tërhiqni deri në nxjerrjen e vendimit nga Gjykata Administrative.

Kujdes!

Tërheqja e padisë është përfundimtare dhe nuk mund të revokohet.

Si ngrihet një kontest administrativ?

Për të ngritur një kontest administrativ, duhet të paraqisni padi në Gjykatën Administrative.

E rëndësishme:

Vetëm ju - pala në procedurë - mund të ngrini një kontest administrativ. Organi mundet gjithashtu të ndërpresë procedurën e filluar sipas detyrës zyrtare.

Si paraqitet një padi?

Padinë mund ta paraqisni:

- Drejtpërdrejt në Gjykatë, me shkrim, ose
- Ta dërgoni me postë.

Padia mund të dërgohet edhe si dërgesë e rekomanduar dhe në këtë rast data e dorëzimit në zyrën postare do të konsiderohet si data e ngritjes së padisë në Gjykatë.

Këshillë:

Nëse dëshironi ta dërgoni padinë me postë, është më mirë ta bëni këtë me postë të rekomanduar, pasi do të keni dëshmi për datën e dërgimit.

Padinë nuk mund ta deklaroni me gojë. Pasi të ngreni padinë, atë mund ta plotësoni.

Çfarë mund të kundërshtohet nga padia?

Me padi mund të kundërshtoni **vetëm një akt**.

Mund të:

1. Kundërshtoni aktin në tërësi ose pjesërisht;
2. Kërkoni që akti të shfuqizohet ose të shpallet nul;
3. Kërkoni miratimin e një akti administrativ individual që nuk është miratuar brenda periudhës së përcaktuar (“heshtja e administratës”); ose
4. Kërkoni ndryshimin e aktit.

Çfarë përmban padia:

E rëndësishme:

Padia duhet të jetë e kuptueshme.

Në padi duhet të shënohet:

1. Emri i gjykatës në të cilën është paraqitur;
2. Emri personal, d.m.th. emri dhe adresa, d.m.th. selia e paditësit, me numrin amë ose numrin tatimor, si dhe adresa e postës elektronike dhe numri i telefonit të kontaktit të paditësit;

3. Emri i të pandehurit (institucion/organ);
4. Akti i kundërshtuar ose përshkrimi i veprimit të kërkuar;
5. Vlera e objektit të kontestit;
6. Kërkesëpadia, d.m.th. ajo që kërkohet nga padia;
7. Nëse akti kundërshtohet tërësisht ose pjesërisht (akti administrativ individual, veprimi ose kontrata administrative);
8. Arsyet për paraqitjen e padisë, të cilat duhet t'i referohen çështjes kryesore dhe kërkesave dytësore ;
9. Faktet dhe provat mbi të cilat bazohet padia;
10. Nënshkrimi juaj/Nënshkrimi i paditësit;

Kujdes!

Zakonisht, kur një padi paraqitet para ndonjë gjykate, paguhet një tarifë gjyqësore. Por **për procedurat në lidhje me të drejtat sociale ka një përjashtim dhe në këto raste nuk duhet të paguani tarifë gjyqësore për të paraqitur padi në Gjykatën Administrative.**

Qytetarët në kontestet administrative nga lëmia e sigurimit social, ndihmës sociale, kujdestarisë dhe biësimit, si dhe për denacionalizim, janë të liruar nga pagesa e taksës gjyqësore.

– Ligji për Taksat Gjyqësore, neni 11
Gazeta Zyrtare e RMV, nr. 114/2009; 148/2011; 106/2013; 166/2014; 257/2020; 205/2023)

E rëndësishme:

Bashkë me padinë duhet të dorëzoni edhe aktin që kundërshtohet.

Këshillë:

Është më mirë të siguroni një kopje, të vërtetuar nga një noter, dhe të mbani origjinalin me vete.

Këshillë:

Padinë dhe bashkëngjitjet duhet t'i dorëtoni në të paktën tre kopje.

Nëse ngreni kontest administrativ për shkak të **“heshtjes së administratës”**, duhet të bashkëngjitni prova kur keni nisur procedurën administrative, ose kur keni paraqitur kërkesën. Një provë e tillë është, për shembull, një kopje e kërkesës së paraqitur, mbi të cilën ekziston një vulë pranimi nga organi/institucioni i shkallës së parë, me datën kur është paraqitur kërkesa, ose një dokument tjetër për pranim, i lëshuar nga organi/institucioni.

Nëse kërkesa nuk përmban elementet e detyrueshme, Gjykata do t'ju kërkojë të korrigjoni këto mangësi brenda një afati të caktuar kohor. Nëse keni harruar të shkruani diçka të rëndësishme në padinë tuaj, nuk keni paraqitur një dokument ose keni bërë një gabim, Gjykata nuk do t'ju refuzojë menjëherë. Gjykata do t'ju dërgojë një njoftim dhe do t'ju japë një afat kohor brenda të cilit duhet t'i korrigjoni ato gabime, në mënyrë që padia të jetë e rregullt.

E rëndësishme:

Duhet të veproni sipas kësaj kërkese të Gjykatës Administrative, sepse, nëse mangësitë nuk korrigjohen, gjykata do të rrëzojë padinë si të çrregullt.

Kundër këtëi vendimi mund të paraqitni ankesë brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Kur duhet të paraqitet padia?

Padinë duhet ta paraqisni brenda 30 ditëve nga data kur keni marrë aktin administrativ.

Nëse padia është për shkak të "heshtjes së administratës", mund të paraqesni padinë pas kalimit të afatit brenda të cilit autoriteti/institucioni duhet të kishte miratuar aktin.

Nëse nuk e keni marrë vendimin/aktin, d.m.th. nuk ju është dorëzuar në përputhje me rregullat për dorëzimin, mund ta paraqisni ankesën brenda 30 ditëve nga momenti që keni marrë dijeni për vendimin, por jo më shumë se një vit nga data e miratimit të vendimit/aktit.

Kujdes!

Vendimi/akti, i miratuar nga autoriteti, duhet të tregojë udhëzimin për padi (mjet juridik) dhe kjo zakonisht është në fund të vendimit/aktit. Nëse në këtë udhëzues gabimisht është shkruar se padia nuk është e lejuar, ndërsa ajo sipas ligjit lejohet, padinë mund ta paraqitni brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti kur keni marrë dijeni ose keni mundur të merrni dijeni për mundësinë e paraqitjes së padisë. Ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se tre vjet nga data e dorëzimit të aktit.

E drejta për t'u informuar për rrjedhën e procedurës

1. Keni të drejtë të informoheni për ecurinë e procedurës;
2. Keni të drejtë të bëni shqyrtimin e lëndës;
3. Keni të drejtë të bëni kopjim të çdo dokumenti të lëndës, në ngarkim të shpenzimeve të tyre, përveç procesverbalit për këshillim dhe votim si dhe dokumenteve të tjera të shënuara me shkallë të sekretisë. Draftet e vendimeve gjyqësore dhe tekstet përgatitore nga puna e Gjykatës nuk janë pjesë e lëndës.

Po sikur Gjykata Administrative të miratojë padinë?

Nëse Gjykata Administrative miraton padinë, ajo duhet të ndërmarrë hapa për zgjidhjen e padisë ose t'i japë udhëzime specifike institucionit/organit të shkallës së parë:

1. Nëse Gjykata konstaton se vendimi/akti nuk është miratuar, ajo do të pranojë padinë dhe do të zgjidhë vetë çështjen administrative.

2. Nëse Gjykata miraton padinë, ajo do të shfuqizojë aktin dhe do t'ia kthejë atë institucionit/organit për rivendim, si vijom më poshtë:

   a) nëse organi i paditur ka vendosur mbi një çështje diskrecionale; ose

   b) nëse natyra e çështjes nuk lejon vendimmarrjen, d.m.th. nuk mund të përcaktojë plotësisht faktet për çështjet thelbësore.

3. Nëse Gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar është i paligjshëm, ajo do të miratojë padinë, do të anulojë aktin/vendimin administrativ individual të kontestuar dhe do të zgjidhë vetë çështjen administrative. Vendimi i gjykatës zëvendëson plotësisht aktin individual të shfuqizuar.

E rëndësishme:

Nëse çështja i kthehet për rishqyrtim, në vendimin e saj Gjykata do t'i urdhërojë institucionit/organit të paditur të nxjerrë një akt individual brenda 15 ditëve nga momenti kur vendimi bëhet përfundimtar.

E rëndësishme:

Institucioni/organi i paditur është i detyruar të marrë mendimin ligjor të Gjykatës në lidhje me zbatimin e ligjit dhe pikëpamjet e tij në procedurë.

E rëndësishme:

Nëse kërkesa juaj është kundër një vendimi/akti që tashmë është shfuqizuar një herë dhe është kthyer në organin e shkallës së parë, Gjykata është e detyruar të zgjidhë vetë çështjen administrative, me anë të së cilës aktgjykimi zëvendëson plotësisht aktin individual të shfuqizuar.

Ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Administrative

1. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative mund të bëni ankim brenda 15 ditëve nga data e dhënies së vendimit.
2. Ankimi nuk lejon që vendimi të bëhet i formës së prerë dhe pezullon ekzekutimin e tij.
3. Ju nuk mund të paraqisni fakte të reja ose të propozoni prova të reja në ankesë, përveç nëse ato lidhen me shkelje thelbësore të procedurës.

Përmbajtja e ankesës

Ankesa duhet së pari të jetë:

1. E kuptueshme
2. Të përmbajë gjithçka që është e nevojshme për t'u trajtuar:
3. Gjykatën
4. Emrin dhe mbiemrin
5. Profesionin dhe vendbanimin, pra vendbanimin e palëve, pra shoqërinë dhe selinë e personit juridik;
6. Përfaqësuesit ligjorë dhe personat me prokurë, nëse ka;
7. Lëndln e kontestit;
8. Aktgjykimin ose i vendimin kundër të cilit paraqitet ankesa;

9. Deklaratën se aktgjykimi ose vendimi është hedhur poshtë tërësisht ose pjesërisht;
10. Arsyet dhe shkaqet e ankesës të shpjeguara;
11. Nënshkrimin e ankimuesit.

Paraqitja e ankesës

Ankesën duhet ta paraqisni në Gjykatën Administrative, në një numër të mjaftueshëm kopjesh, si për Gjykatën ashtu edhe për palët e tjera.

Ankesën e pafatshme, të paplotë ose të palejuar Gjykata do ta hedhë poshtë, pa mbajtur seancë, brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë.

E rëndësishme:

Kur Gjykata e Lartë Administrative vepron sipas ankesës kundër aktvendimit i cili një herë tashmë është shfuqizuar dhe është kthyer për rishqyrtim pranë Gjykatës Administrative, ajo është e detyruar që ta zgjidhë vetë çështjen administrative dhe me aktgjykim ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë.

Graf. 3 – Kontest administrativ



USHTRIMI I DISA PREJ TË DREJTAVE TË LIGJIT PËR MBROJTJEN SOCIALE

Mund t'i realizoni këto të drejta për ndihmë financiare nga mbrojtja sociale:

- Ndihmë minimale e garantuar;
- Shtesë për shkak të aftësisë së kufizuar
- Shtesë për ndihmë dhe përkujdesje nga personi tjetër;
- Kompensim i pagës për orar të shkurtuar të punës:
- Shtesë për banim;
- Ndihmë e përhershme;
- Ndihmë e njëhershme financiare.

Kush mund të përfitojë nga e drejta për mbrojtje sociale?

Përfituesit e së drejtës për mbrojtje sociale mund të jenë:

- shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut që kanë vendbanimin e tyre të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- të huajt që kanë rregulluar vendbanimin e përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut që nuk kanë vendbanim të përhershëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- të huajt që kanë një qëndrim të përkohshëm të rregulluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të cilët përfitojnë nga të drejtat e mbrojtjes sociale në kushte të përcaktuara me ligje, marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- një person që aplikon për të drejtën e azilit, një person me statusin e refugjatit të njohur dhe një person nën mbrojtje plotësuese, si dhe një person që nuk është regjistruar në certifikatën e lindjes, dhe ka një certifikatë nga një libër amëz të veçantë të lindjes dhe dokument identifikimi, sipas kushteve dhe në një procedurë të përcaktuar me ligj.

Kush ka të drejtë për mbrojtje sociale?

Ju keni të drejtë për mbrojtje sociale nëse nuk mund të siguroni mbështetje përmes punës suaj, përmes të drejtave që rrjedhin nga puna ose sigurimi, nga prona, nga burime të tjera, nga persona që janë të detyruar me ligj për t'ju mbështetur, ose ndryshe.

Shembull: Ju keni të drejtë për ndihm; sociale vetëm nëse me të vërtetë nuk keni ndonjë mënyrë tjetër për të siguruar shpenzimet e jetesës. Kjo do të thotë që nuk keni punë, nuk keni pension ose ndihmë tjetër, nuk keni pronë që sjell para dhe nuk keni të afërm të ngushtë të cilëve u kërkohet ligjërisht t'ju ndihmojnë.

E drejta për mbrojtje sociale bazohet në trajtim të barabartë dhe ndalohen të gjitha llojet dhe format e diskriminimit.

E rëndësishme:

Në procedurën e ndihmës sociale, shtetasi nuk mbulon asnjë shpenzim për marrjen e dokumenteve.

Shtetasi nuk është i detyruar të paraqesë prova të të dhënave për të cilat organi shtetërore mban shënime zyrtare, siç është certifikata e shtetësisë, ose certifikata, ekstrakte, licenca, leje të ndryshme, etj.

Si mund të fillohet procedura për ushtrimin e së drejtës për mbrojtje sociale?

Procedura fillon me paraqitjen e një kërkese.

Kërkesa mund të paraqitet nga vetë shtetasi ose përfaqësuesi i tij ligjor, kujdestari ose organi shtetëror, sipas detyrës zyrtare.

A mundet Qendra për Punë Sociale të fillojë vetë një procedurë?

Qendra për Punë Sociale mundet, sipas detyrës zyrtare, mund të iniciojë procedurë me iniciativë të vet ose me iniciativë të qytetarit, organit kompetent, respektivisht të organit dhe organizatës tjetër, kur kjo është në interes të qytetarit ose kur ekziston interesi i personave të tretë.

Procedura para Qendrës për Punë Sociale

Sipas kërkesës për ealizimin e së drejtës nga mbrojtja sociale, në shkallë të parë, vendos Qendra për Punë Sociale kompetente për territorin në të cilin keni vendbanim ose vendqëndrim.

E rëndësishme:

Për kërkesën tuaj, në procedurën e ushtrimit të së drejtës për mbrojtje sociale, Qendra për Punë Sociale është e detyruar të marrë një vendim brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm.

Ankesa

Nëse nuk jeni të kënaqur me aktvendimin e Qendrës së Punës Sociale, mund të paraqisni një ankesë. Ankesa vendoset nga Ministria.

Ankesa paraqitet nëpërmjet qendrës kompetente të punës sociale. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

Të drejtat për ndihmë financiare

Të drejtat për ndihmë financiare nga mbrojtja sociale ushtrohen nga data e paraqitjes së kërkesës, në rast se vendimi është pozitiv.

Shembull: Nëse dorëzoni një kërkesë më 1 prill dhe institucioni miraton kërkesën tuaj më 31 maj, ata janë të detyruar t'ju kthejnë paratë si për muajin prill ashtu edhe për muajin maj.

Të drejtat për ndihmë financiare nga mbrojtja sociale do të pushojnë në ditën e përfundimit të kushteve për përdorimin e së drejtës.

USHTRIMI I DISA PREJ TË DREJTAVE SIPAS LIGJIT TË SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR

Cilat të drejta të sigurimit pensional dhe invalidor mund të ushtrojnë qytetarët?

Qytetarët kanë të drejtë për:

- pension të pleqërisë
- pension invalidor
- rehabilitimi profesional dhe të drejtat për përfitime përkatëse në para;
- pension familjar
- kompensim në para për dëmtimet trupore, dhe
- shumën minimale të pensionit

Si fitohen dhe ushtrohen të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor?

Fitimi dhe ushtrimi i këtyre të drejtave varet nga:

- Mënyra;
- Gjatësia; dhe
- Shuma e fondeve të investuara për sigurimin pensional dhe invalidor.

A mund të humbasin të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor?

Të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor:

- nuk mund të merren;
- janë pasuri personale materiale;
- nuk mund të transferohen te të tjerët;
- nuk mund të vjetërohet, përveç nëse fondet nuk mund të disbursohen për shkak të rrethanave të shkaktuara nga përfituesi i së drejtës1;
- mund të kufizohen vetëm me ligj.

Fondet sigurohen duke paguar kontributin e sigurimit pensional dhe invalidor, në përputhje me ligjin.

E rëndësishme:

Ju keni të drejtë të ankoheni kundër vendimit të Fondit të Sigurimit Pensional dhe Invalidor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (FSPIMV) dhe të drejtës për mbrojtje gjyqësore.

1 Lexo më shumë në f. 28

Kur mund të realizohet pensioni i pleqërisë?

Për të përfituar pension pleqërie duhet të plotësohen dy kushte: përvojën e punës dhe moshën.

1. Duhet të keni të paktën 15 vjet përvojë pune.
2. Burrat e realizojnë këtë të drejtë në moshën 64 vjeç, gratë në moshën 62 vjeç.

Si përcaktohet pensioni i moshës?

Baza e pensionit

Për përcaktimin/llogaritjen e pensionit të moshës, së pari duhet të llogaritet baza juaj e pensionit. Llogaritja bëhet nga Fondi SPIMV.

Për përcaktimin e bazës së pensionit merren pagat, përfitimet në para, pra bazat e sigurimit që ju keni rrealizuar në përputhje me ligjin dhe një marrëveshje kolektive.

Të drejtat në bazë të invaliditetit

Çfarë është invaliditeti?

Invaliditeti është ndryshim në gjendjen shëndetësore që nuk mund të eliminohet me mjekim ose me reabilitim mjekësor, për shkak të të cilit aftësia e punës është zvogëluar përhershëm për më shumë se gjysmën, në krahasim me një person të shëndoshë fizikisht dhe psiqikisht me arsim dhe aftësi të njëjtë ose të ngjashme

Ekzistojnë tre shkallë të invaliditetit:

1. Paaftësia e përgjithshme për punë ose humbja e përhershme e aftësisë për punë. Në këto raste, aftësia e punës është zvogëluar për më shumë se 80%. (Kategoria I)
2. Paaftësia profesionale për punë ose kur aftësia e punës është zvogëluar për më shumë se 50%, ndërsa më së shumti deri në 80%. (Kategoria II)
3. Nëse aftësia e punës është zvogëluar për 50%, personi (i siguruari) mund të punojë me orar të shkurtuar të punës ose të sistemohet në një punë tjetër të përshtatshme. Invaliditeti mund të ndodhë për shkak të sëmundjes, lëndimit jashtë punës, lëndimit në punë ose sëmundjeve profesionale.

E rëndësishme:

Nëse përcaktohet paaftësia profesionale për punë, do të përcaktohet kapaciteti i mbetur i punës dhe nëse rehabilitimi profesional mund t'ju mundësojë të punoni me kohë të plotë në një punë tjetër.

Të drejtat bazuar në aftësinë e mbetur për të punuar:

- **E drejta për rehabilitim profesional** – lloji varet nga mosha, nga vendi ku ka ndodhur dëmtimi (jashtë ose në punë), si dhe nga vitet e përvojës së punës;
- **E drejtë për kompensim të pagës në lartësi të pensionit të invaliditetit** – nëse keni fituar të drejtën për reabilitim profesional, nën kushte të caktuara dhe më së shumti 12 muaj për invalidët e punës;
- **Pensioni invalidor** - kur ndodh një paaftësi e përgjithshme për punë, si dhe kur keni aftësi të mbetura pune, por për shkak të moshës, nuk mund të trajnoheni për të kryer punë të tjera të përshtatshme me rehabilitimin profesional.



Ushtrimi, përdorimi dhe humbja e të drejtave

Si mund të ushtroni të drejtat tuaja të sigurimit pensional dhe invalidor?

Mund të ushtroni të drejtat tuaja në Fondin për SPIMV. Fondi është gjithashtu kompetent kur të drejtat e sigurimit pensional dhe invalidor ushtrohen në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara.

E drejta e sigurimit pensional dhe invalidor mund të ushtrohet nga një person që ka cilësinë e personit të siguruar sipas këtij ligji.

Si ushtrohet e drejta për pension familjar?

- Ushtrimi i të drejtës së pensionit familjar dhe të drejtave të tjera të anëtarëve të familjes së
- të siguruarit, pra përfituesit të një pensioni, do të ushtrohet me kërkesë të një anëtari të familjes.

Pensionin familjar mund ta fitojnë:

1. Bashkëshorti/ja;
2. Fëmijët (të lindur në martesë ose jashtë martese ose të birësuar, thjeshtrit të cilët i ka mbajtur personi i siguruar, nipërit e mbesat dhe fëmijët e tjerë pa prindër të cilët i ka mbajtur personi i siguruar);
3. Prindërit (babai dhe nëna, njerku dhe njerka) dhe prindi birësues që i ka mbajtur personi i siguruar;
4. Bashkëshorti nga martesa e divorcuar, nëse me vendim gjykate është përcaktuar e drejta e mbajtjes;
5. Nipër e mbesa jetimë, fëmijë të tjerë jetimë dhe prindër që i ka mbajtur personi i siguruar.

Kompensimi monetar për dëmtim trupor

Dëmtimi trupor ekziston nëse keni humbje, dëmtim më substancial ose paaftësi më të theksuar të organeve të veçanta ose të pjesëve të trupit që e vështirësojnë aktivitetin normal të organizmit dhe kërkojnë sforcim më të madh në realizimin e nevojave jetësore, pa marrë parasysh nëse shkaktojnë ose nuk shkaktojnë invaliditet.

Keni të drejtë për kompensim monetar për dëmtim trupor nën kushtet e njëjta në pikëpamje të stazhit pensional sikurse për të drejtën për pension invaliditeti.

Invaliditet

Procedurën për përcaktimin e invaliditetit, përveç sipas kërkesës suaj, mund ta iniciojë edhe punëdhënësi pranë të cilit jeni në marrëdhënie pune, si dhe mjeku amë dhe komisioni mjekësor i Fondit të Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (FSSHVRNM).

Me kërkesën, respektivisht propozimin për përcaktimin e invaliditetit ose të paaftësisë për punë, duhet të bashkëngjitni dokumentacion mjekësor, pune dhe dokumentacion tjetër, si dhe propozimin nga komisioni mjekësor pranë FSSHVRNM-së.

Procedura për përcaktimin e invaliditetit ose të paaftësisë për punë, përsëri inicohet nga komisioni i Fondit pas skadimit të afatit prej një viti nga dita e kontrollit. Kjo procedurë mund të ngrihet edhe para skadimit të këtij afati, nëse me kërkesën është bashkëngjitur dokumentacion i ri mjekësor për ndryshimin e ndodhur, respektivisht nëse ka ardhur deri te përkeqësimi i gjendjes shëndetësore.

E rëndësishme:

Si i siguruar, jeni i detyruar të merrni pjesë në këtë procedurë.

Dokumentet për stazhin dhe të dhënat nga evidenca zyrtare të cilën e mban një organ tjetër publik, Fondi i Pensional i siguron sipas detyrës zyrtare, pas pëlqimit të dhënë paraprakisht me shkrim për shfrytëzimin e të dhënave personale.

Dokumentet e tjera i sigurojnë parashtruesi dhe anëtarët e tjerë të familjes, si gjatë parashtrimit të kërkesës, ashtu edhe gjatë kohës së shfrytëzimit të së drejtës për pension invalidor.

Ku mund të ushtroni të drejtat tuaja të sigurimit pensional dhe invalidor?

Kërkesa për realizimin e së drejtës nga sigurimi pensional dhe invalidor parashtrohet, në formë letre, në filialet dhe zyrat e Fondit Pensional sipas vendit të sigurimit të fundit.

Ju gjithashtu mund të paraqisni një kërkesë për të përcaktuar ndryshimet në gjendjen tuaj të paaftësisë dhe shkallën e dëmtimeve trupore që ndikojnë në një të drejtë tashmë të njohur.

Përjashtimisht, organi kompetent për vendimmarrje mbi përfitimet e sigurimeve të pensionit dhe të paaftësisë mund, me nismën e një mjeku, Komisionit për Vlerësimin e Aftësisë së Punës, punëdhënësit ose Fondit PIOHS, të urdhërojë ri-ekzaminimin e personave të paaftë për punë për shkak të aksidentit në punë, me aftësi pune të mbetur, për të përcaktuar ndryshimet në gjendjen e tyre të paaftësisë

Procedura

Për ushtrimin e të drejtave në bazë të invaliditetit dhe paaftësisë për të punuar, krijohet një Komision në kuadër të Fondit Pensional.

Në konstatimin, vlerësimin dhe mendimin, përcaktohet edhe detyrimi për kontroll të obligueshëm mjekësor i cili kryhet në afat jo më të shkurtër se një vit nga dita e përcaktimit të invaliditetit.

Kontrolli mjekësor mund të kryhet jo më shumë se dy herë deri në mbushjen e moshës 65-vjeçare të shfrytëzuesit të pensionit. Disa sëmundje janë të përjashtuara nga ky kontroll mjekësor.

Kontrollin e detyrueshëm mjekësor nuk mund ta kryejnë personat e njëjtë të cilët më parë kanë marrë pjesë në procedurën për përcaktimin e invaliditetit.

Deri në sjelljen e vendimit, pas kontrollit të kryer të detyrueshëm mjekësor, duhet t'ju paguhet pension i përkohshëm invaliditeti, respektivisht pension familjar.

E rëndësishme:

E drejta për pension invalidor, respektivisht pension familjar pushon nëse nuk paraqiteni në kontrollin e detyrueshëm mjekësor në afatin e përcaktuar, ose nëse me kontrollin mjekësor nuk përcaktohet invaliditeti, respektivisht paaftësia për punë.


Mbrojtja ligjore

Kundër vendimit të sjellë në shkallë të parë nga Fondi Pensional parashtruesi i kërkesës ka të drejtë ankese pranë Komisionit Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës në Shkallë të Dytë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Ankesa nuk e shtyn zbatimin e vendimit.

Kundër vendimit të Komisionit Shtetëror për Vendosje në Procedurë Administrative dhe Procedurë të Marrëdhënies së Punës, në shkallë të dytë, mund të ngrihet padi administrative.

Graf. 4 – Procedura për realizimin e të drejtave në bazë të invaliditetit dhe paaftësisë për punë



Si mund t'i shfrytëzoni ose t'i humbni të drejtat?

1. Të drejtat nga sigurimi pensional dhe invalidor fitohen dhe lindin me ditën e plotësimit të kushteve, nëse kërkesa është parashtruar në afat prej gjashtë muajsh nga dita e plotësimit të kushteve. Nëse parashtroni kërkesë pas skadimit të këtij afati, të drejtat fitohen edhe për gjashtë muaj më parë.
2. E drejta për pension pleqërie realizohet pas ndërprerjes së sigurimit (d.m.th. pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës) dhe me plotësimin e të dy kushteve të theksuara në f. 22.
3. E drejta për pension invaliditeti në bazë të vendimit për invaliditet të përcaktuar, mund të realizohet më së voni në afat prej tre muajsh nga plotfuqishmëria e vendimit për invaliditet. Nëse e drejta për pension invalidor nuk realizohet në këtë afat, do t'ju udhëzojnë në kontroll të përsëritur komisionar, sipas detyrës zyrtare.
4. Pensioni dhe kompensimet e tjera monetare përcaktohen në vlerë mujore dhe do t'ju paguhen pasi të përfundojë muaji. Për shembull, në mars do t'i merrni paratë për shkurt.
5. Nëse jeni shfrytëzues i pensionit ose i kompensimit monetar, mund të autorizoni një person tjetër që, në emrin Tuaj, ta pranojë pensionin ose kompensime monetare.
6. Me kërkesë të Fondit Pensional, shfrytëzuesi i pensionit ose i kompensimit monetar është i detyruar të dorëzojë vërtetim jete të lëshuar nga Fondi Pensional.
7. Nëse shfrytëzuesi ka vendbanim jashtë territorit të Republikës, Fondi Pensional do të sigurojë pagesën e vlerave nën kushtet e parashikuara me ligj, me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar ose nëse ekziston reciprociteti.
8. E drejta për reabilitim profesional dhe kompensimet monetare mund të kufizohen, respektivisht të pushojnë, nëse në afat prej një muaji:
   - Nuk filloni me reabilitimin profesional; ose
   - Nëse pa shkaqe të arsyeshme e ndërpreni reabilitimin profesional;
   - Nëse nuk e kryeni detyrën në lidhje me reabilitimin; ose
   - Nëse në afatin e caktuar nuk i përgjigjeni ftesës për vlerësim të përsëritur të aftëses për punë.
9. Nëse jeni shtetas i huaj dhe nëse shpërnguleni, pensioni dhe kompensimi monetar për dëmtim trupor do t'ju paguhen jashtë shtetit, nëse me shtetin përkatës është lidhur marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar për pagesën e pensioneve jashtë shtetit, ose nëse ekziston reciprociteti

Marrja e pensionit jashtë vendit

Nëse jeni shfrytëzues i pensionit - shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut - i cili shpërngulet jashtë shtetit, pensioni dhe të hyrat e tjera monetare do t'ju paguhen nëse një detyrim i tillë është parashikuar me marrëveshje ndërshtetërore, respektivisht me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar.

E rëndësishme:

Jeni të detyruar ta paraqitni çdo ndryshim që ndikon mbi të drejtën ose mbi vëllimin e shfrytëzimit të së drejtës, më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita kur ka ndodhur ndryshimi.

Dy ose më shumë pensione

Nëse fitoni të drejtën për dy ose më shumë pensione, sipas këtij ligji, shfrytëzuesi mund të shfrytëzojë vetëm një nga ato pensione, sipas zgjedhjes personale. Pas zgjedhjes së kryer, i siguruari nuk ka të drejtë zgjedhjeje të përsëritur.

Pensioni familjar paguhet si një pension edhe kur u është caktuar më shumë shfrytëzuesve, përderisa bashkëshfrytëzuesit nuk kërkojnë që pensioni t'u paguhet ndaras.

Shembull: Nëse një vëlla dhe një motër do të ndajnë një pension familjar, shteti automatikisht do të dërgojë të gjithë shumën e pensionit në një llogari transaksioni (si një pension të përbashkët). Por nëse ata nuk pajtohen ose nëse duan që të gjithë të marrin paratë në llogarinë e tyre, ata mund t'i kërkojnë Fondit të "ndajë" pensionin. Pastaj të gjithë do të marrin pjesën e tyre, në llogari të veçanta.

Pensioni si objekt i përmbarimit

Nëse keni borxhe, një përmbarues mund të marrë vetëm një pjesë të pensionit tuaj, jo të gjithë.

Zakonisht, përmbaruesi mund t'ju marrë deri në 1/3 (një të tretën) e pensionit. Për shembull, nëse pensioni juaj është 30.000 denarë, përmbaruesi mund t'ju marrë deri në 10.000 denarë. Por, nëse keni borxh para për alimentacion (mbajtjen e fëmijës ose të anëtarit të familjes), përmbaruesi mund t'ju marrë deri në gjysmën e pensionit.

Por, nëse pranoni vlerën më të ulët të pensionit (pensionin minimal të pleqërisë ose familjar), Ju jeni të mbrojtur ligjërisht dhe përmbaruesi nuk guxon t'ju marrë para për asnjë lloj borxhi si kredi ose fatura. Rasti i vetëm kur mund t'ju ndalet një pjesë e pensionit minimal është nëse keni një detyrim të përcaktuar me vendim gjykate për pagesën e alimentacionit, siç është për shembull mbajtja e fëmijës ose e anëtarit të familjes. Madje edhe atëherë mund t'ju marrin më së shumti një të tretën e pensionit brenda muajit, dhe atë vetëm nëse Ju personalisht pajtoheni dhe nënshkruani se lejoni t'ju ndalen ato para.

Kompensimi monetar për dëmtim trupor nuk mund të jetë objekt i përmbarimit dhe i sigurimit, më saktësisht përmbaruesi nuk mund t'ju ndalë ose t'ju marrë këto para për të mbledhur ndonjë borxh.

Shumat mujore të detyrueshme

Shumat mujore të pensionit dhe përfitimeve të tjera të sigurimeve shoqërore që nuk mund të paguhen për shkak të rrethanave të shkaktuara nga përfituesi mund të paguhen me efekt prapaveprues për një maksimum prej tre vjetësh, llogaritet nga dita kur, pas ndërprerjes së atyre rrethanave, përfituesi paraqet një kërkesë për pagesë.

Shembull: "Rrethanat e shkaktuara nga përfituesi i së drejtës" i referohen situatave kur ju si pensionist keni bërë disa lëshime ose gabime për shkak të të cilave Fondi Pensional nuk ka mundur të paguajë pensionin tuaj në kohë. Kjo më së shpeshti do të thotë se:

- Keni harruar të raportoni një ndryshim. Për shembull, keni ndryshuar llogarinë bankare ose të transaksionit dhe nuk keni njoftuar Fondin Pensional, kështu që paratë nuk kanë ku të shkojnë.
- Nuk keni dhënë një dokument të kërkuar. Për shembull, nuk keni dhënë vërtetim jete me kërkesë të Fondit Pensional.
- Keni qenë i padisponueshëm. Për shembull, keni qenë jashtë vendit ose nuk i keni tërhequr paratë për një kohë të gjatë, prandaj pagesa është ndërprerë përkohësisht.

Në raste të tilla, sapo të rregulloni problemin, shteti do t'ju paguajë të gjitha pensionet e prapambetura, por më së shumti për tri vjet prapa nga dita kur kërkoni përsëri pagesën. Çdo gjë që ka kaluar para atyre tri viteve humbet dhe nuk do t'ju paguhet.

USHTRIMI I DISA PREJ TË DREJTAVE TË LIGJIT PËR SIGURIMIN SHËNDETËSOR

Çfarë lloj sigurimi shëndetësor ekziston dhe kush e zbaton atë?

Sigurimi shëndetësor mund të jetë i detyrueshëm dhe vullnetar.

Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor zbatohet nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut (FSSHM).

Sigurimi shëndetësor vullnetar ofron shërbime shëndetësore që nuk mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor. Sigurimi shëndetësor vullnetar mund të kryhet nga shoqëritë e sigurimit, jo nga FSSHM.

Kush janë personat me sigurim shëndetsor?

Personat e siguruar janë persona të siguruar dhe anëtarë të familjes. Si anëtarë të familjes konsiderohen: bashkëshorti/ja dhe fëmijët e lindur brenda ose jashtë martese, fëmijët e birësuar dhe fëmijët e marrë në mbështetje.

Fëmijët mbulohen nga sigurimi shëndetësor:

1. deri në moshën 18-vjeçare, ndërsa pas këtyre viteve vetëm nëse janë në shkollim të rregullt, por më së voni deri në moshën 26-vjeçare;
2. kur janë në shkollim me korrespondencë, nëse për shkak të natyrës së sëmundjes nuk janë në gjendje ta ndjekin rregullisht mësimin; dhe
3. nëse janë ose bëhen të paaftë për jetë dhe punë të pavarur, sipas rregullave të sigurimit pensional dhe invalidor, respektivisht të mbrojtjes sociale, për gjatë gjithë kohës sa zgjat kjo paaftësi.

Çfarë të drejtash nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor kanë qytetarët?

Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor u siguron personave të siguruar të drejtën e shërbimeve shëndetësore bazë sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj, në rast të:

1. sëmundjes dhe lëndimeve jashtë punës dhe
2. lëndimeve në punë dhe sëmundjeve profesionale.

Cilat janë të drejtat për përfitime në para sipas sigurimit të detyrueshëm shëndetësor?

Në kuadër të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor sigurohet e drejta për kompensime monetare, edhe atë:

1. e drejta për kompensim të pagës gjatë paaftësisë së përkohshme për punë për shkak të sëmundjes dhe lëndimit dhe gjatë mungesës nga puna për shkak të shtatzënisë, lindjes dhe
2. e drejta për kompensim të shpenzimeve të udhëtimit.

1. Kompensimi i pagave

E drejta për kompensim të pagës gjatë paaftësisë së përkohshme për punë mund të realizohet në rast të:

1. sëmundjes dhe lëndimit jashtë punës;
2. lëndimit në punë dhe sëmundjes profesionale;
3. mjekimit dhe ekzaminimit mjekësor;
4. kujdesit për fëmijën e sëmurë deri në moshën trivjeçare;
5. kujdesit për anëtarin e sëmurë të familjes së ngushtë mbi moshën trivjeçare, por më së shumti deri në 30 ditë;
6. shoqërimit të domosdoshëm të personit të sëmurë të udhëzuar për kontroll ose mjekim jashtë vendbanimit;
7. shoqërimit të domosdoshëm të fëmijës së sëmurë deri në moshën trivjeçare, derisa është në mjekim spitalor, por më së shumti deri në 30 ditë;
8. dhurimit vullnetar të gjakut, indit ose organit; dhe
9. izolimit me qëllim të parandalimit të infeksionit.

E rëndësishme:

Kompensimi i pagës paguhet që nga dita e parë e paaftësisë për punë dhe zgjat gjatë gjithë kohës sa zgjat paaftësia për punë, ndërsa paguhet për ditët për të cilat realizohet paga.

Lartësinë e kompensimit të pagës gjatë paaftësisë së përkohshme për punë e përcakton punëdhënësi, respektivisht Fondi me akt të përgjithshëm, por të paktën në vlerë prej 70% nga baza për kompensimin e pagës.

Përjashtim: Lartësia e kompensimit të pagës gjatë paaftësisë së përkohshme për punë, të shkaktuar nga lëndimi në punë, sëmundja profesionale, gjatë dhurimit të gjakut, indit ose organit, si dhe gjatë mungesës për shkak të shtatzënisë, lindjes dhe amësisë, është 100% e bazës së kompensimit të pagës.

Procedura e kompensimit të pagës

Dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e së drejtës për kompensim të pagës e siguron personi zyrtar i autorizuar nga FSSHM-ja, i cili është i detyruar që, në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, t'i kërkojë dëshmitë nga organi publik kompetent. Organi publik kompetent është i detyruar që dokumentacionin e kërkuar ta dorëzojë në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Formularin e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm për plotësimin e kushteve i përcakton FSSHM-ja.

Si të merrni një vlerlsim të paaftësisë për punë?

Vlerësimin për paaftësinë e përkohshme për punë, për 15 ditët e para, e jep mjeku amë. Për çdo pushim mjekësor më të gjatë se aq, nga dita e 16-të e tutje, vendos komisioni (komisioni mjekësor i shkallës së parë i FSSHM-së, me propozim të mjekut amë).

Paaftësia e përkohshme për punë përcaktohet me:

- Kontroll të drejtpërdrejtë mjekësor të të siguruarit dhe
- Shqyrtim të dokumentacionit mjekësor dhe dokumentacionit tjetër.

Ekzistojnë përjashtime nga kjo rregull nëse personi i siguruar është i sëmurë rëndë, i paaftë për lëvizje ose me aftësi të kufizuara të rënda dhe nuk po merr trajtim spitalor. Në raste të tilla, paaftësia e përkohshme për punë mund të përcaktohet edhe pa praninë e personit të siguruar.

Vlerësimin për paaftësi të përkohshme për punë qytetari/i siguruari duhet ta dorëzojë te punëdhënësi, respektivisht në FSSHM, në afat prej tetë ditësh nga skadimi i 15 ditëve, respektivisht 16 ditëve (varësisht nga ajo nëse pushimi mjekësor është më pak se 15 ditë ose më shumë). Gjegjësisht, nëse pushimi mjekësor është deri në 15 ditë, keni afat prej 8 ditësh nga skadimi i 15 ditëve të para për ta dorëzuar vlerësimin. Nëse pushimi mjekësor është mbi 15 ditë, keni afat prej 8 ditësh nga skadimi i 16 ditëve të para për ta dorëzuar vlerësimin.

Nëse nuk jeni i kënaqur me vlerësimin, mund ta ankimoni. Nëse vlerësimi ju është lëshuar nga mjeku amë, mund të parashtroni ankesë në komisionin mjekësor të shkallës së parë, ndërsa nëse vlerësimi ju është lëshuar nga komisioni mjekësori shkallës së parë, mund të parashtroni ankesë në komisionin mjekësor të shkallës së dytë.

Nëse punëdhënësi juaj dëshiron, mund të formojë një komision mjekësor të autorizuar për të rishikuar vlerësimin. Kostot e shkaktuara për formimin, funksionimin e tij dhe çdo ekzaminim mjekësor shtesë të nevojshëm mbulohen nga punëdhënësi.

Gjithashtu, punëdhënësi, respektivisht FSSHM-ja, në varësi të atij që paguan përfitimin e pagës, mund të kërkojë rishikimin e vlerësimit të paaftësisë së përkohshme nga komisioni mjekësor i shkallës së parë ose i shkallës së dytë (në varësi të atij që lëshoi vlerësimin).

Në rast të një periudhe të zgjatur të paaftësisë së përkohshme për punë, që zgjat deri në 12 muaj, komisioni mjekësor do t'ju referojë te autoriteti kompetent për një vlerësim të aftësisë suaj për punë, në përputhje me rregulloret për sigurimet socilae dhe të paaftësisë.

A mund të ndërpritet kompensimi i pagës gjatë paaftësisë së përkohshme për punë?

Pagesa e kompensimit të pagës gjatë paaftësisë së përkohshme për punë mund të ndërpritet, nëse:

1. i siguruari pa arsye nuk paraqitet në kontrollin e caktuar mjekësor ose komisionar dhe mjekim, ose me vetëdije nuk u përmbahet udhëzimeve të mjekut;
2. gjatë kohës së paaftësisë së përkohshme për punë vërtetohet se i siguruari punon dhe realizon të ardhura; dhe

3. i siguruari është punëdhënësi tek i cili nuk ka të punësuar të tjerë (person i vetëpunësuar), ndërsa në atë periudhë realizon të ardhura.

A mund të mjekoheni jashtë vendit?

Mund të shfrytëzoni mjekim spitalor jashtë shtetit, me miratim paraprak të FSSHM-së, nëse bëhet fjalë për sëmundje e cila nuk mund të mjekohet në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ndërsa në shtetin ku i siguruari udhëzohet për mjekim ekziston mundësia për mjekim të suksesshëm, si dhe kontrolle mjekësore që lidhen me mjekimin spitalor të kryer tashmë jashtë shtetit, të miratuar nga Fondi.

Me shtetet me të cilat kemi lidhur ose marrë përsipër Marrëveshje për sigurim social, shërbimet shëndetësore jashtë shtetit mund t'i shfrytëzoni në vëllim dhe në mënyrë të përcaktuar me Marrëveshjen për sigurim social.

Në shtetet me të cilat nuk kemi lidhur ose marrë përsipër Marrëveshje për sigurim social, mund të shfrytëzoni shërbime shëndetësore jashtë shtetit vetëm për dhënien e ndihmës mjekësore urgjente, nëse kontributi për sigurim të obligueshëm shëndetësor është paguar në përputhje me rregullat për sigurim të obligueshëm social.

Nëse i siguruari ose punëdhënësi i cili e ka udhëzuar të siguruarin në punë të përkohshme jashtë shtetit, në shtetet me të cilat Republika e Maqedonisë së Veriut nuk ka lidhur ose marrë përsipër Marrëveshje për sigurim social dhe shfrytëzim të mbrojtjes shëndetësore jashtë shtetit, por atë e ka siguruar në barrë të vet me marrëveshje të veçantë për sigurim, shërbimet e dhëna shëndetësore nuk bien në barrë të Fondit.

Personat e siguruar që kanë vendbanim në shtetin me të cilin Republika e Maqedonisë së Veriut ka lidhur ose ka marrë përsipër marrëveshje për sigurim social, në atë shtet mund të shfrytëzojnë shërbime shëndetësore në vëllim dhe në mënyrë të përcaktuar me marrëveshjen për sigurim social.

Personat e siguruar që qëndrojnë përkohësisht jashtë shtetit mund të shfrytëzojnë vetëm ndihmë mjekësore urgjente.

Cila është procedura për ushtrimin e të drejtave nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor?

Kërkesa për realizimin e të drejtave nga sigurimi i detxrueshëm shëndetësor, në shkallë të parë, i parashtrohet FSSHM-së. Kërkesa mund të jetë në formë të shkruar dhe/ose në formë elektronike.

Kërkesën në formë të shkruar mund ta parashtroni çdo ditë pune, gjatë orarit të punës së FSSHM-së, ndërsa kërkesën në formë elektronike mund ta parashtroni edhe jashtë orarit të punës, si dhe në ditët jopunuese, ndërsa afati për veprim sipas kërkesës fillon të rrjedhë nga dita e parë e ardhshme e punës.

Kërkesa në formë elektronike parashtrohet duke përdorur mjet për identifikim elektronik, përmes ueb-portalit të FSSHM-së ose përmes Portalit Nacional për Shërbime Elektronike.

Përmbajtjen dhe formën e formularit, si dhe dokumentacionin e nevojshëm që i bashkëngjitet kërkesës, i përcakton FSSHM-ja.

Dokumentacionin e nevojshëm të theksuar në formularin e kërkesës, **si shtetësia dhe certifikata nga libri amë, janë dëshmi të cilat FSSHM-ja i siguron sipas detyrës zyrtare**.

Vendimi në shkallë të parë, për të drejtat nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor, miratohet nga FSSHM-ja, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së rregullt dhe të plotë.

Kur para sjelljes së vendimit duhet të vërtetohet gjendja faktike për të cilën nevojitet edhe mendim nga komisionet mjekësore të FSSHM-së, FSSHM-ja është e detyruar të sjellë vendim në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës së rregullt dhe të plotë.

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet **kontest administrativ**. Vendimi për kontestin administrativ duhet të merret në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të padisë së rregullt.

Në procedurat për realizimin e së drejtës për trajtim jashtë shtetit, në shkallë të parë, vendos FSSHM-ja, në bazë të mendimit të komisionit mjekësor të shkallës së parë për trajtim jashtë shtetit, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

Kundër vendimit të komisionit mjekësor të shkallës së parë për mjekim jashtë shtetit, personi i siguruar ka të drejtë ankese deri te Këshilli Drejtues i FSSHM-së, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të sjellë në shkallë të parë. Këshilli Drejtues është i detyruar të sjellë vendim më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të ankesës, në bazë të mendimit të komisionit mjekësor të shkallës së dytë për mjekim jashtë shtetit.

Kundër këtij vendimi mund të ngrihet **kontest administrative**.

Kompensimi i dëmit

Nëse është kryer pagesë nga mjetet e FSSHM-së, jeni të detyruar ta ktheni vlerën e pranuar dhe ta kompensoni dëmin, nëse:

- keni realizuar të hyra në bazë të të dhënave të rreme;
- nuk keni paraqitur ndryshime që ndikojnë në humbjen ose vëllimin e së drejtës, ndërsa keni ditur ose keni qenë të detyruar të dini për ato ndryshime;
- keni pranuar të hyra më të mëdha se vlera që ju është përcaktuar me vendim të FSSHM-së.

